



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

|                                                         |                     |
|---------------------------------------------------------|---------------------|
| REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO |                     |
| AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT                            |                     |
| AGENCIA PROTIV KORUPCIJE                                |                     |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY                                  |                     |
| Dep.                                                    | Nr. Prot.           |
| Dep. 20/DPK                                             | Br. Prot. 01-987/15 |
| Dep.                                                    | Prot No.            |
| Nr. i faq.                                              | Data                |
| Broj stranica                                           | Datum               |
| Nr. pages 06                                            | Date 01.04.2015     |
| PRISHTINË                                               |                     |

|                        |                                                                                                 |
|------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATË/A:                | 01.04.2015                                                                                      |
| REFERENC-Ë:            | DPK- DPKPP 03-4999/14                                                                           |
| PËR/ZA/TO:             | z. Agim FEJZULLAHI<br>Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme |
| CC:                    | z. Driton GASII<br>Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme                  |
| NGA/OD/FROM:           | Hasan PRETENI<br>Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit                                        |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me Tenderin me titull " Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve të MPB-së "      |

***I nderuari z. Fejzullahi ,***

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me Tenderin " Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve të MPB-së " ( Vazhdim afati ) me numër prokurimi: 214-14-051-211 Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

## O P I N I O N

Kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme në drejtim të evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me aktivitetin e Prokurimit me titull " Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve të MPB-së " ( Vazhdim afati ) me numër prokurimi: 214-14-051-211, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme.

### *Arsyetimi*

Ministria e Punëve të Brendshme si Autoriteti kontraktues, përmes Departamentit të Prokurimit ka iniciuar procedurën e prokurimit me titull " Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve të MPB-së " ( Vazhdim afati ) me numër prokurimi: 214-14-051-211. Më datë 02.12.2014 ka bërë publikimin e Njoftimit për Kontratë, përmes faqes elektronike të KRPP-së, ndërsa me datë 19 dhe 24 dhjetor të vitit 2014 ka bërë edhe dy zgjatje të afatit të tenderimit.

Autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur me vlerë të madhe të kontratës, duke bërë ndarjen e këtij aktiviteti të prokurimit në 5 lote ( pjesë ) ku në lot 1 është paraparë të bëhet Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve Volkswagen, lot 2 Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve të tipit Hyundai, lot 3 Mirëmbajtja dhe Servisimi i tipeve tjera të vogla dhe tereni, lot 4 Mirëmbajtja dhe Servisimi i Kamionëve dhe lot 5 Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjetit Audi. Agjencia kundër Korrupsionit me dt.26.12.2014 ka paraqitur Njoftimin zyrtar pranë autoritetit kontraktues të cilin e ka njoftuar, se përfaqësuesit e AKK-së do të marrin pjesë në cilësinë e monitoruesit në vlerësimin e ofertave për Tenderin në fjalë.

Zyrtarët Përgjegjës të Agjencisë kundër Korrupsionit kanë marr pjesë në vëzhgimin e punës së Komisionit vlerësues, rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit e tenderëve dhe pasi kanë shqyrtuar me kujdes të gjitha dokumentet përkatëse për këtë aktivitet të prokurimit kanë konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr gjithsej **31** Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar **14** OE.

Komisioni vlerësues, pasi ka ekzaminuar, krahasuar dhe vlerësuar ofertat për të gjitha lotët (pjesët) ka konstatuar dhe ardhur në përfundimet si në vijim: Për 1 ka pasur **11** oferta ku **3** nga këto oferta sipas Komisionit vlerësues janë në përputhje substanciale me kushtet administrative, i plotësojnë kërkesat minimale për kualifikim, kanë përputhshmëri substanciale me kushtet teknike të kërkuara dhe janë kualifikuar për vlerësim të mëtutjeshëm. Për lot 2 ka pasur **8** oferta ku **3** prej tyre i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim. Për lot 3 ka pasur **8** oferta ku **3** i plotësojnë kriteret minimale dhe janë kualifikuar për vlerësim të mëtutjeshëm. Për lot 4 ka pasur **5** oferta ku **3** nga këto oferta sipas Komisionit vlerësues i plotësojnë kërkesat minimale për kualifikim, mirëpo në shqyrtimin analitik të listës së çmimeve të disa pozicione (auto pjesë) Komisioni vlerësues ka vërejtur tek të gjitha lotet se çmimet janë shumë të ulëta në disa pozicione të Specifikimeve teknike, e tek disa pozicione tjera janë ofruar çmime shumë të larta mbi vlerën e tregut. Lidhur me këtë Komisioni vlerësues i ka rekomanduar Zyrtarët Përgjegjës të Prokurimit që tu drejtoj letrën standarde për informata lidhur me tenderët jo-normalisht të ulët



Operatorëve ekonomik të cilët kanë ofruar çmimet më të ulëta dhe janë kualifikuar për vlerësim të mëtutjeshëm.

Autoriteti Kontraktues ka pranuar përgjigjet e arsyetuara me shkrim nga 3 prej 4 Operatorëve ekonomik të cilët i kanë plotësuar kriteret minimale dhe ka konstatuar se përgjigjet e ofruara nga ana e tyre nuk janë reale, bindëse dhe të mjaftueshme, andaj Komisioni vlerësues ka konstatuar se çmimet e ofruara janë jo normalisht të ulëta dhe jashtë çdo çmimi të tregut.

Tek lot 5 ka pasur 2 oferta, ku sipas Komisionit vlerësues asnjëra prej tyre nuk i plotësojnë kërkesat minimale për kualifikim, andaj në mungesë të ofertave të përgjegjshme për të gjitha lotët Komisioni vlerësues ka rekomanduar anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit për të gjitha lotet.

#### Konstatimet e Agjencisë

Agjencia pasi ka ekzaminuar dhe analizuar me kujdes dokumentacionin përkatës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe pasi ka monitoruar procesin e vlerësimit të tenderëve, ka vërejtur se tek pjesa e kriterëve për dhënie të kontratës Autoriteti Kontraktues ka përdorur kriterin Tenderi ekonomikisht më i favorshëm sipas peshës së çmimit, ndërsa si nën kriterë ka caktuar për pjesën

a) Totali për servisim të rregullt të cilin e ka peshu me 50%, b) është kërkuar totali, për mirëmbajtje- Riparimet dhe pjesët e ndërrimit të cilit i është caktuar pesha prej 30%, c) Totali, Riparim, Ngjyrosje i cili është peshu me 5%, dhe d) Totali, Pjesët dhe materiali i ndërrimit të cilit nën-kriter i është caktu pesha prej 15 %. Kriterë këto për të cilat AKK konsideron se janë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik. Nga e tërë kjo mund të nënkuptohet se Autoriteti Kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar Tenderin ekonomikisht më të favorshëm sipas peshës së çmimit, ndërsa si nën kriterë i ka caktuar katër kategoritë ku parashihen pjesë të ndryshme të automjeteve dhe në kuadër të katër kategorive ka përcaktuar çmimin më të ulët për secilën kategori të pjesëve. Operatorët ekonomik të cilët kanë ofruar çmimet më të ulëta për secilën kategori kanë fituar pikët maksimale dhe nga kjo konstatohet se qëllimi i Autoritetit kontraktues ka qenë që të caktoj si kriter matës vetëm çmimin më të ulët.

Sipas aneksit 5 të Dosjes së Tenderit tek pjesa e kriterëve për dhënie të kontratës, nëse Autoriteti Kontraktues ka caktuar si kriter matës vetëm çmimin më të ulët atëherë sipas pikës 2 të këtij aneksi i njëjti nuk ka pasur të drejtë ta përdor formulën për peshimin e pikëve.

Sipas këtij Ligji si kriterë për dhënie të kontratës parashihen të jenë dy çmimi më i ulët dhe Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, tek i cili përveç çmimit duhet të parashihen edhe nën kriterë tjera si cilësia, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencë teknike e jo të jetë vetëm çmimi më i ulët si kriter matës.

Në rast se Autoriteti Kontraktues ka për synim që ta gjej çmimin më të ulët brenda ofertave, atëherë duhet që si kriter për dhënie të kontratës ta caktoj çmimin më të ulët e jo që për brenda kriterit Tenderi ekonomikisht më i favorshëm ta caktoj si nën kriter vetëm çmimin më të ulët.

Pas, analizimit të Specifikimeve teknike dhe listave të çmimeve të ofruara nga Tenderuesit janë vërejtur çmimet jo- normalisht të ulëta si në vijim e në disa tjera çmime shumë të larta. Në pjesën a) ku është paraparë Servisimi i rregullt ku bëjnë pjesë vaji i motorit, filteri i vajit, naftës, ajrit, klimës dhe puna e dorës njëri nga Operatorët ekonomik ka ofruar çmimin prej vetëm 8.30 € për disa automjete ndërsa tek një pozicion ku kanë qenë të përfshira më shumë automjete janë ofruar çmime prej 75.70 €. Në pjesën ku është paraparë identifikimi i defekteve të ndryshme sponat, frenat, dritat, rrotat, trapi i parë dhe i mramë komplet regllazha janë ofruar çmime prej 0.01 €. Në pjesën b) Mirëmbajtja dhe pjesët rezervë janë ofruar çmimet si në vijim: vaji i motorit 0.50 €, filteri i vajit, naftës, ajri dhe klimës janë ofruar me çmim prej 0.50 €, piston (klipi) 0.50 €, sensori i ABS-it 0.50 €, Filteri i Klimës 0.01 €, fellnet metalike 0.01 €, pasqyret anësore 0.50 €, pasqyra e brendshme 0.50 €. Në pjesën ku janë paraparë pjesët rezervë janë ofruar çmimet si në vijim: Sensor para të frenave dhe prapa 0.10 €, Litari i qelikt i frenit të dorës 1.00 € për disa Automjete ndërsa për disa tjera 66.00 €, mbajtësi i djathët dhe i majtë janë ofruar me çmime prej 0.50 €, alternatori 1.00 €, pompa e naftës 1.00 €, Ngjyrosja e derës 1.00 €, Ngjyrosja e derës së bagazhit 1.00 €, zingjir dimri për vetura 1.00 €, Mollza 144.00 €, 77.00 €, 55.00 €, ndërsa për disa vetura tjera është ofruar çmim prej 1.00 €, Spona qendrore 188.00 €, 77.00 €, ndërsa për disa automjete tjera është ofruar çmimi prej 0.01 € dhe 1.00 €, diodat e alternatorit 0.01 € diskat e mramë 0.01 €, Turbina është ofruar me çmim prej 1.222.00 për një lloj të veturës, ndërsa për disa lloje tjera është ofruar me çmim prej 1.00 €, kompresori i klimës prej 333.00 € deri 666.00 € për 2 lloje të automjeteve, ndërsa për shumicën e veturave tjera është ofruar me çmim prej vetëm 1.00 €, mollza 0.10 €, goma të verës 1.20 €. Ndërsa goma dimri 245.00 €, mbushja e klimës 1.20 €, gypi i klimës 0.50 €, ventilatori i klimës 0.50 €.

Vlen të përmendet se shumica e Operatorëve ekonomik tek pjesa a) ku ka qenë i paraparë Totali për servisim të rregullt i cili nën kriter ka peshu me 50%, kanë ofruar çmime shumë të ulëta nën vlerën e tregut në mënyrë që të fitojnë sa më shumë pikë të mundshme, ndërsa në nën kriteret tjera ku janë paraparë më pak poena kanë ofertuar me çmime shumë me të larta jashtë çdo vlere të tregut dhe pikërisht një veprim i tillë nga ana e Operatorëve ekonomik, mund të jetë një rrezik shumë i madh për Autoritetin Kontraktues që të paguaj çmime shumë të larta tek nën kriteret tjera ku janë paraparë më pak poena, e që në këto kategori janë paraparë shumë pjesë të Automjeteve. Kjo ndërlikohet me mos formulimin e drejtë të nën kritereve për dhënie të kontratës nga ana e Autoritetit kontraktues, pasi që pikërisht përdorimi i nën kritereve të tilla ju mundëson Operatorëve ekonomik që ofrojnë çmime shumë të larta dhe në këtë mënyrë rrezikon që të dëmtohet në thelb buxheti i Autoritetit kontraktues.



Autoriteti kontraktues duhet që çdo herë të kujdeset që ti përdor në mënyrë sa më ekonomike fondet publike duke paguar çmime reale konform me çmimet e tregut në mënyrë që të mos ketë keqpërdorim të parasë publike.

Agjencia gjithashtu ka vërejtur se në disa raste Komisioni vlerësues tek rubrika kapaciteti teknik dhe profesional pika i) ku janë kërkuar se paku dy kontrata për shërbimet e ngjashme në tri vitet e shkuara, para datës së publikimit të njoftimit për kontratë. Komisioni vlerësues ka pranuar kontrata dhe referenca të vitit 2014, ani pse procedura e prokurimit ishte iniciuar me dt.02.12.2014 dhe që ende nuk kishte përfunduar viti fiskal 2014, madje në disa raste Komisioni nuk i ka pranuar kontratat dhe referencat para datës 02.12.2011 e ka pasur raste që ka pranuar pas kësaj date. Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të Operatorëve ekonomik Autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë kontrata dhe referenca për shërbime e ngjashme, por nëse vendosin në kërkesë të tillë atëherë detyrimisht duhet që kontratat dhe referencat ti kërkojnë për 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, e që në këtë rast do duhej të pranoheshin kontratat dhe referencat për tërë vitin fiskal 2011,2012 dhe 2013.

Komisioni vlerësues pasi ka ekzaminuar, krahasuar dhe vlerësuar me kujdes të gjitha ofertat ka konstatuar se nuk ka oferta të përgjegjshme për shkak të çmime jo- normalisht të ulëta, andaj në mungesë të tenderëve të zbatueshëm ka rekomanduar anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Autoriteti Kontraktues me dt.20.02.2015, përmes faqes elektronike të KRPP-së ka bërë publikimin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit me arsyetimin se janë pranuar më pak se dy oferta të përgjegjshme.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, Nenin 27 Dosja e Tenderit Nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale. Nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-së.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit kërkon që të veprohet konform rekomandimeve që dalin nga ky Opinion dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !